

ARGUMENTUM
news opinion analysis

REVOLUCIONI I FLAMINGOVE:

**FUNDI I TRANZICIONIT TË
STËRZGJATUR SHQIPTAR**

Revista e parë në Shqipëri e dedikuar analizës gjeopolitike

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Që prej vitit 2022, **Argumentum.al** vjen edhe në formatin e një reviste të përmuajshme, duke krijuar një hapësirë të veçantë për analizën, reflektimin dhe interpretimin e zhvillimeve më të rëndësishme në Shqipëri, rajon dhe botë.

Revista Argumentum synon të shkojë përtej lajmit të ditës, duke analizuar forcat, aktorët dhe dinamikat që formësojnë realitetin politik, diplomatik dhe gjeopolitik. Çdo numër sjell një përzgjedhje artikujsh, analizash dhe opinionesh mbi zhvillimet kryesore kombëtare, rajonale dhe globale.

Përmes kontributit të ekspertëve, analistëve, studiuesve dhe personaliteteve të njohura të politikës

dhe publicistikës shqiptare e ndërkombëtare, **Revista Argumentum** synon të jetë një platformë e besueshme për mendimin analitik dhe debatin mbi çështjet që ndikojnë të tashmen dhe të ardhmen tonë.

Ju ftojme të shfletoni Revistën Argumentum në gjuhën shqipe dhe angleze dhe të ndiqni analizat tonam bipolitikën, diplomacinë, sigurinë dhe zhvillimet gjeopolitike që formësojnë botën ku jetojmë.

ARGUMENTUM

Përtej lajmit. Analizojmë forcat që formësojnë botën.

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 Revolucioni i Flamingove: Fundi i Tranzicionit të Stërzgjatur Shqiptar.

07 Integrim pa anëtarësim: Komisioni Evropian propozon model të ri për vendet candidate .

11 SHBA dhe Irani nënshkruajnë marrëveshjen historike për t'i dhënë fund luftës në Lindjen e Mesme.

14 Lufta që gjeografia refuzoi ta humbte.

18 Rusia në botën moderne.

20 "Nga 'agjentët e huaj' te 'fashistët': Kush janë në të vërtetë protestuesit?"

22 Maskirovka Ballkanike: Pse "distancimi" i Moskës është vetëm një operacion për mbijetesën e regjimit të Vuçiçit.

27 Në Tivat na morën me të mirë! Paqe i thëncin! Ujdi po, paqe jo! Po BE/ SHBA ku janë ? 5 zgjedhje, asnjë zgjidhje!

30 Rama për "Financial Times": Unë nuk jam kumbari i Shqipërisë.

32 Bilanci i Ferit Hoxhës: Shqipëria më e respektuar dhe më e besueshme se kurrë.

34 Zgjedhjet e qershorit në Kosovë, nuk prodhuan as humbës klasik dhe as fitues absolut!

36 Romano Prodi: Nëse Europa vdes, vdes edhe qytetërimi.

38 Samiti ASEAN: diplomacia e Putinit mes iluzionit të suksesit dhe kufijve të realitetit.

40 Samiti i G7 në Évian: Liderët miratojnë një deklaratë të gjerë mbi Ukrainën, Lindjen e Mesme dhe sigurinë globale.

43 Rama alleges 'hybrid war' behind protests against Kushner-linked coastal development.

45 Council of Albanian Ambassadors Backs Civic Protests, Calls for Transparency and Protection of National Interests.

46 Serbia's Lost Legal Battle and the Exploitation of Resolution 1244 for Lawfare and Terrorism.

50 The visit that changed Albania's strategic future.

53 Pierre Nora and the institution of memory we lack in Eastern Europe.

55 Just kind words in Tivat! Where is the peace!? A deal yes, peace No!What is happening with USA and EU? 5 elections but no solution!

58 Daniel Serwer: A Bad War Ending Badly May Still Be Good News.

60 G7 Leaders Present Unified Geopolitical Agenda at Évian Summit.



REVOLUCIONI I FLAMINGOVE:

Fundi i Tranzicionit të Stërzgjatur Shqiptar

Protestat masive të qershorit, të pagëzuara tashmë nga pjesëmarrësit si “Revolucioni i Flamingove”, mund të shënojnë fundin e tranzicionit më të gjatë postkomunist në Europë. Nëse rrëzimi i komunizmit në Shqipëri u vulos de facto nga revolta studentore e vitit 1990 me thirrjen historike “E duam Shqipërinë si gjithë Europa”, atëherë kjo lëvizje e re qytetare mund të konsiderohet si përmbyllja simbolike e një epoke 35-vjeçare. Shqipëria ishte ndër vendet e

fundit europiane që iu bashkua valës së përmbylljes së regjimeve komuniste pas shembjes së Murit të Berlinit. Megjithatë, vendi ynë hyri në një tranzicion të gjatë, të vështirë dhe shpeshherë të dhimbshëm, që zgjati më shumë se në çdo vend tjetër të Ballkanit dhe Europës Lindore. Një tranzicion i mbushur me kriza politike, ekonomike e sociale, të cilat lanë gjurmë të thella në jetën e shqiptarëve.

Pavarësisht vështirësive, populli shqiptar ka pasur gjithmonë një orientim të qartë dhe të palëkunj-

dur: integrimin në Bashkimin European. Edhe pse shpesh zyrtarë europianë apo ndërkom-bëtarë na etiketojnë thjesht si një vend ballkanik, ne i përkasim natyrshëm qytetërimit european dhe kemi qenë kontribuues historikë të këtij kontinenti.

Megjithatë, politika shqiptare nuk ka arritur ende të përm-bushë standardet, kriteret dhe detyrimet e nevojshme për t’u bërë pjesë e plotë e tryezës politike europiane. Prej 35 vitesh, Shqipëria është qeverisur krye-sisht nga dy partitë më të mëdha

politike: Partia Demokratike dhe Partia Socialiste. Herë njëra e herë tjetra kanë mbajtur pushtetin, duke dominuar jetën politike të vendit.

Aktualisht, Partia Socialiste, nën drejtimin e Edi Ramës, ndodhet në mandatin e saj të katërt radhazi në krye të qeverisë. Një periudhë e gjatë qeverisjeje që ka sjellë jo pak pakënaqësi. Sot, mijëra qytetarë protestojnë para godinës së Kryeministrit dhe në rrugët kryesore të Tiranës, jo vetëm kundër qeverisë aktuale, por kundër një klase politike që ka drejtuar vendin për më shumë se tre dekada.

Gjatë këtyre viteve kemi dëgjuar shpesh politikanë të ndryshëm të mburren me pjesëmarrjen e tyre në protestat që rrëzuan komunizmin. Disa madje i kanë atribuar vetes role dhe merita që nuk u përkasin. Por këtë gjykim le ta bëjë historia dhe ndërgjegjia e secilit.

Ironikisht, pikërisht kjo klasë politike, ku një pjesë e protagonistëve të sotëm e kanë nisur karrierën e tyre në emër të demokracisë, ka dështuar ta kultivojë atë. Demokracia jo vetëm që nuk lulëzoi siç pritej, por shpesh u përdor si mjet për të konsoliduar pushtetin absolut, si nga Partia Demokratike, ashtu dhe nga Partia Socialiste, sigurisht me ndihmën e partive më të vogla që kanë lindur po nën ombrellën e këtyre dy forcave të mëdha.

Katërmëdhjetë vitet e qeverisjes së Edi Ramës janë shoqëruar me largimin e qindra mijëra të rinjve nga vendi. Studentë, profesionistë, intelektualë dhe punëtorë të kualifikuar, pra truri dhe energjia më e madhe e Shqipërisë sot jetojnë dhe kontribuojnë në ven-



det më të zhvilluara europiane, në kërkim të një jete më të mirë. Por drama e emigracionit nuk është thjesht një perceptim. Ajo është e dokumentuar në shifra. Sipas Censusit të vitit 2023, Shqipëria ka rreth 420 mijë banorë më pak sesa në vitin 2011, ndërsa popullsia rezidente ka zbritur në rreth 2.4 milionë banorë. Vetëm në dy vitet e fundit, migracioni neto ka mbetur negativ me dhjetëra mijëra qytet-

arë që kanë zgjedhur të largohen. Këto statistika demografike janë treguesi më i qartë i dështimit të tranzicionit. Çdo i ri që largohet është një votë mosbesimi ndaj sistemit politik, ekonomik dhe institucional të ndërtuar gjatë 35 viteve të fundit.

Kjo është arsyeja pse zemërimi që po shfaqet sot në rrugët e Tiranës nuk lidhet vetëm me një qeveri apo me një mandat të caktuar. Ai lidhet me faktin se

“

Katërmëdhjetë vitet e qeverisjes së Edi Ramës janë shoqëruar me largimin e qindra mijëra të rinjve nga vendi. Studentë, profesionistë, intelektualë dhe punëtorë të kualifikuar, pra truri dhe energjia më e madhe e Shqipërisë sot jetojnë dhe kontribuojnë në vendet më të zhvilluara europiane, në kërkim të një jete më të mirë.

Shqipëria, një vend i bekuar me bukuri natyrore dhe pasuri të jashtëzakonshme, vazhdon të mbetet në udhëkryq. Në vend që këto pasuri të shërbejnë për mirëqenien e qytetarëve, ato shpesh janë kthyer në instrumente të pasurimit të shpejtë të elitave politike dhe ekonomike. Nga ana tjetër, Shqipëria po varfërohet nga burimi i saj më i çmuar: njerëzit. Sovrani është shpesh i nëpërkëmbur, ndërsa në emër të tij justifikohen projekte gjigante, investime me shifra marramendëse dhe premtime që mbeten vetëm në letër.



politika shqiptare ka dështuar të mbajë premtimin themelor: t'u japë shqiptarëve arsye për të jetuar dhe për të ndërtuar të ardhmen në vendin e tyre.

Ndërkohë, Shqipëria, një vend i bekuar me bukuri natyrore dhe pasuri të jashtëzakonshme, vazhdon të mbetet në udhëkryq. Në vend që këto pasuri të shërbejnë për mirëqenien e qytetarëve, ato shpesh janë kthyer në instrumente të pasurimit të shpejtë të

elitave politike dhe ekonomike. Nga ana tjetër, Shqipëria po varfërohet nga burimi i saj më i çmuar: njerëzit. Sovrani është shpesh i nëpërkëmbur, ndërsa në emër të tij justifikohen projekte gjigante, investime me shifra marramendëse dhe premtime që mbeten vetëm në letër. Sazani, Zvërneci dhe shumë projekte të tjera të debatueshme janë bërë simbol i një tranzicioni që duket se ka humbur kuptimin e

tij fillestar.

Por durimi ka një kufi.

Pas 35 vitesh pritjeje, zhgënjimesh dhe premtimesh të pambytura, qytetarët kanë dalë sërish në rrugë. Dhe ja ku provohet se shqiptarët nuk janë as të nënshtruar, as indiferentë. Ata reagojnë kur ndihen të tradhtuar dhe kur shohin se ata që duhet t'i udhëheqin kanë humbur drejtimin.

Ata që duhej ta udhëhiqnin këtë vend e kanë humbur drejtimin. Dhe ky popull, që për vite me radhë është neglizhaur, sot po ngre zërin për të kërkuar llogari nga ata që kanë administruar fatet e tij.

Por nëse revolta e studentëve të vitit 1990 i dha fund komunizmit, Revolucioni i Flamingove mund të jetë momenti që shënon fundin e tranzicionit të stërzgatur shqiptar.

Ndaj kjo protestë është shumë





më tepër sesa një lëvizje e zakonshme politike.

Prandaj, aty mes atyre njerëzve që dalin çdo ditë dhe protestojnë, ka shpresë. Ka të rinj, prindër, fëmijë, gjyshër e gjyshe, njerëz të zakonshëm që ende besojnë se ky vend mund të bëhet. Por jo me këtë klasë politike. Shqipëria

mund të bëhet nga bijtë dhe bijat e saj që e duan vërtet këtë vend, që janë patriotë në kuptimin më të mirë të fjalës.

Dhe patriot nuk do të thotë vetëm të valëvitësh flamurin. Patriot do të thotë të duash çdo cep të atdheut, ta mbrosh, ta zhvillosh dhe të kujdesesh për të.

Të mos e shohësh Shqipërinë si një plaçkë për t'u ndarë, por si një trashëgimi që duhet lënë më e mirë për brezat që vijnë.

Pas 35 vitesh pritjeje, premtimesh të pambajtura dhe zhgënjimesh të njëpasnjëshme, shqiptarët nuk kërkojnë më thjesht rotacion politik, por një kontratë të re mes shtetit dhe qytetarit, një republikë që funksionon për shumicën dhe jo për një pakicë të privilegjuar.

Mbetet për t'u parë nëse kjo lëvizje do të arrijë objektivat e saj. Por një gjë është tashmë e qartë, frika, indiferenca dhe apatia që kanë shoqëruar jetën publike shqiptare për dekada po zëvendësohen nga kërkesa për përgjegjësi, pjesëmarrje dhe ndryshim. Për herë të parë pas shumë vitesh, mijëra qytetarë po kërkojnë të jenë protagonistë të së ardhmes së tyre dhe jo thjesht spektatorë të saj.

Sepse Shqipëria nuk është pronë e politikanëve.

Shqipëria është e shqiptarëve.



Integrim pa anëtarësim: Komisioni Evropian propozon model të ri për vendet kandidate



Komisioni Evropian po harton plane për t'u dhënë vendeve kandidate të BE-së përfitime ekonomike përpara se ato të bashkohen me bllokun, ndërsa qeveritë kërkojnë mënyra për të përshpejtuar zgjerimin pa ulur nivelin e hyrjes, sipas politico.eu.

Propozimet janë pjesë e shtytjes së Komisionit për "integrim gradual" – duke i shpërblyer kandidatët me akses më të madh në BE, ndërsa ata kryejnë reforma ndërsa kërkesat e tyre për anëtarësim janë ende duke u përpunuar, sipas dy zyrtarëve të cilëve u është dhënë anonimiteti për të diskutuar zhvillimet e brendshme.

Përfitimet që po diskutohen përfshijnë aksesin në disa programe financimi të BE-së, marrëveshje

tregtare preferenciale dhe akses të pjesshëm në tregun e vetëm para anëtarësimit, me paketën e saktë që do të përshtatet me progresin e secilit vend kandidat.

Qëllimi është të mbahen vendet kandidate në rrugën e duhur duke u dhënë atyre stimuj për të çuar përpara reformat e vështira politikisht edhe nëse anëtarësimi i plotë është vite larg.

Ndryshe nga idetë e mëparshme për "zgjerim të kundërt", të cilat do t'u kishin dhënë vendeve të drejta politike përpara se të përfundonin procesin e pranimit (plani u refuzua nga kryeqytetet e BE-së), integrimi gradual do të ofronte përfitime ekonomike në stilin e anëtarësimit pa i sjellë vendet në BE përpara se ato të konsiderohen gati.

INTEGRIMI GRADUAL: URË DREJT BE-SË APO STATUS I PËRHERSHËM NË PRITJE?

Propozimi i Komisionit Evropian për "integrimin gradual" ngre një debat shumë më të gjerë sesa ai i përfitimeve ekonomike. Për vendet kandidate, përfshirë Shqipërinë, pyetja kryesore është nëse kjo qasje do ta përshpejtojë realisht anëtarësimin apo do të krijojë një status të ri, ku ato do të gëzojnë disa përfitime të Bashkimit Evropian pa u bërë kurrë pjesë e vendimmarrjes së tij.

Në pamje të parë, modeli duket tërheqës. Aksesin në fondet evropiane, në tregun unik dhe në programe të ndryshme do të sillte përfitime të prekshme ekonomike. Megjithatë, këto avantazhe shoqërohen me një paradoks: vendet kandidate do të duhet të zbatojnë një pjesë të legjislacionit të BE-së dhe të respektojnë rregullat e saj, por pa marrë pjesë në institucionet ku këto rregulla hartohen.



Propozimet vijnë ndërsa qeveritë bien dakord gjerësisht se zgjerimi duhet të ecë më shpejt, veçanërisht në dritën e luftës së Rusisë kundër Ukrainës, por mbeten të kujdesshme për pranimin e vendeve përpara se ato të jenë plotësisht të përgatitura. Prandaj, Brukseli po përpaket të përshpejtojë procesin, duke ndërtuar masa mbrojtëse më të forta për të siguruar kryeqytetet skeptike.



Propozimi tashmë ka më shumë vull politik sesa planet e mëparshme.

Franca dhe Gjermania – dy fuqitë më të mëdha të BE-së – kanë mbështetur më parë ide të ngjashme “anëtarësimi të lehtë” për vendet që përballen me afate të gjata pranimi, dhe zyrtarët janë optimistë se qasja do të jetë më e pranueshme për kryeqytetet sesa skemat e mëparshme.

“Duhet të ketë një integrim ekonomik paralel, por të domosdoshëm”, tha Petras Austrevicius, eurodeputeti lituanes i cili hartoi strategjinë e zgjerimit të Parlamentit Evropian.

“Parimi më shumë për më shumë është testuar mirë dhe duhet të përqafohet si mbështetje për ata kandidatë që përparojnë më mirë se të tjerët”, shtoi ai.

Komisioni do të kërkojë mbështetje nga kryeqytetet e BE-së për iniciativën, me zyrtarët që shpresojnë se udhëheqësit do të miratojnë punën për një kornizë më të gjerë në një Këshill Evropian në tetor ose dhjetor.

“Sipas planeve, qasja në përfitime do të jepet rast pas rasti në varësi të asaj se sa është përafëruar secili vend me rregullat e BE-së dhe sa reforma kanë zbatuar”, tha një zyrtar.

Kjo do të shënonte një largim të rëndësishëm nga sistemi aktual, sipas të cilit shumica e përfitimeve janë të rezervuara për anëtarët e plotë.

Propozimet vijnë ndërsa qeveritë bien dakord gjerësisht se zgjerimi duhet të ecë më shpejt, veçanërisht në dritën e luftës së Rusisë kundër Ukrainës, por mbeten të kujdesshme për pranimin e vendeve përpara se ato të jenë plotësisht të përgatitura.

Prandaj, Brukseli po përpaket të përshpejtojë procesin, duke ndërtuar masa mbrojtëse më të forta për të siguruar kryeqytetet skeptike.

Qasja është hartuar gjithashtu për të mbajtur vendet candidate si Ukraina – pranimi i së cilës ka të ngjarë të zgjasë me vite pavarësisht mbështetjes së fortë politike – plotësisht të angazhuara në

proces pa premtuar anëtarësim të shpejtë.

Vendet do të duhet të “ndërtojnë” akses në përfitime ndërsa zbatojnë reformat, tha një zyrtar, duke



MARTA KOS

Momentum për reformën më të gjerë të zgjerimit ka munguar përndryshe. Ndërsa udhëheqësit e BE-së ranë dakord në një samit në Mal të Zi në fillim të këtij muaji se procesi i pranimi duhet të përshpejtohet, diskutimet mbi mënyrën e arritjes së kësaj kanë humbur vrellin që atëherë.

ndihmuar në sigurimin e qeverive të shqetësuara për zgjerimin e përfitimeve të anëtarësimit për joanëtarët.

Pas një takimi me zyrtarët moldavë të hënën, Komisioni tha se do të ndjekë si pranimin e vendit ashtu edhe “thellimin e integritetit gradual të Moldavisë në Bashkimin Evropian”.

Moldavisë tashmë i është ofruar akses në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro, marrëveshjet e roaming-ut celular të BE-së dhe programet e mbështetjes kulturore.

Komisionerja e Zgjerimit Marta Kos tha se tani varet nga qeveritë të vendosin se si ta çojnë debatin përpara.

Momentum për reformën më të gjerë të zgjerimit ka munguar përndryshe. Ndërsa udhëheqësit e BE-së ranë dakord në një samit në Mal të Zi në fillim të këtij muaji se procesi i pranimit duhet të përshpejtohet, diskutimet mbi mënyrën e arritjes së kësaj kanë humbur vrullin që atëherë.

BE-ja aktualisht ka nëntë vende

zyrtare kandidate. Mali i Zi shihet gjerësisht si favorit për anëtarësim, ndërsa Ukraina dhe Moldavia kanë hapur bisedimet e pranimit. Të tjerë, përfshirë Serbinë, Turqinë dhe Gjeorgjinë, kanë parë aplikimet e tyre të ngecin.

Ndërsa integrimi gradual synon ta bëjë pranimin më tërheqës, si Ukraina ashtu edhe Mali i Zi kanë kundërshtuar konceptin “anëtarësim i lehtë” të propozuar nga Franca dhe Gjermania, duke argumentuar se ai nuk duhet të bëhet zëvendësim për anëtarësimin e plotë.

Meqenëse propozimet e mëparshme të Komisionit për “zgjerim të kundërt” nuk kanë arritur të fitojnë mbështetje nga vendet e BE-së, komisionerja e Zgjerimit Marta Kos tha se tani u takon qeverive të vendosin se si ta çojnë përpara debatin.

Kancelari gjerman Friedrich Merz është ndër udhëheqësit që po shtojnë përpara qasje alternative dhe kishte ndërmend ta ngrinte çështjen në samitin

”

Një diplomat i përfshirë në bisedime tha se zyrtarët po përpiqeshin të kompensonin një “dekadë të humbur” të reformës së zgjerimit, duke kapërcyer rezistencën nga qeveritë e vendosura për të siguruar që vendet kandidate të përfundojnë reforma kuptimplote para se të bashkohen. Kos i tha POLITICO-s më parë këtë muaj se Komisioni po zhvillon gjithashtu masa të reja mbrojtëse që do të “shtrëngojnë fort” nëse vendet e ardhshme anëtare tërhiqen nga demokracia ose shteti i së drejtës pas anëtarësimit – një përpjekje tjetër për të siguruar qeveritë se blloku mund të përshpejtojë zgjerimin pa dobësuar standardet e tij.

e Këshillit Evropian të javës së kaluar.

Por, rendi i ditës u tejkalua, duke mos lënë kohë për një diskutim thelbësor, sipas tre zyrtarëve.

Në vend të kësaj, udhëheqësit pritët t’i rikthehen çështjes në takimin e tyre të tetorit.

Një diplomat i përfshirë në bisedime tha se zyrtarët po përpiqeshin të kompensonin një “dekadë të humbur” të reformës së zgjerimit, duke kapërcyer rezistencën nga qeveritë e vendosura për të siguruar që vendet kandidate të përfundojnë reforma kuptimplote para se të bashkohen.

Kos i tha POLITICO-s më parë këtë muaj se Komisioni po zhvillon gjithashtu masa të reja mbrojtëse që do të “shtrëngojnë fort” nëse vendet e ardhshme anëtare tërhiqen nga demokracia ose shteti i së drejtës pas anëtarësimit – një përpjekje tjetër për të siguruar qeveritë se blloku mund të përshpejtojë zgjerimin pa dobësuar standardet e tij.

Integrim gradual apo anëtarësim





i dorës së dytë?

Propozimi i Komisionit Evropian për “integrimin gradual” ngre një debat shumë më të gjerë sesa ai i përfitimeve ekonomike. Për vendet kandidate, përfshirë Shqipërinë, pyetja kryesore është nëse kjo qasje do ta përshpejtojë realisht anëtarësimin apo do të krijojë një status të ri, ku ato do të gëzojnë disa përfitime të Bashkimit Evropian pa u bërë kurrë pjesë e vendimmarrjes së tij.

Në pamje të parë, modeli duket tërheqës. Aksesit në fondet evropiane, në tregun unik dhe në programe të ndryshme do të sillte përfitime të prekshme ekonomike. Megjithatë, këto avantazhe shoqërohen me një paradoks: vendet kandidate do të duhet të zbatojnë një pjesë të legjislacionit të BE-së dhe të respektojnë rregullat e saj, por pa marrë pjesë në institucionet ku këto rregulla hartohen.

Kjo ngre pikëpyetje mbi parimin themelor të Bashkimit Evropian, atë të barazisë mes shteteve anëtare. Anëtarësimi nuk është vetëm një paketë përfitimesh

ekonomike; ai nënkupton të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrje, për të pasur një komisioner, deputetë në Parlamentin Evropian dhe një zë në Këshillin e Bashkimit Evropian. Nëse ven-

“

Për Shqipërinë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, kjo mund të jetë një mundësi për të përfituar më herët nga procesi i integrit, por njëkohësisht edhe një rrezik që anëtarësimi i plotë të shtyhet pafundësisht. Nëse qytetarët dhe ekonomitë marrin një pjesë të përfitimeve, motivimi politik i vendeve anëtare për të përfunduar procesin e zgjerimit mund të zbehet.

”

det kandidate marrin vetëm përfitimet ekonomike, ndërsa vendimmarrja mbetet ekskluzivisht në duart e shteteve anëtare, atëherë krijohet rreziku i një Evrope me disa nivele integrimi.

Për Shqipërinë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, kjo mund të jetë një mundësi për të përfituar më herët nga procesi i integrit, por njëkohësisht edhe një rrezik që anëtarësimi i plotë të shtyhet pafundësisht. Nëse qytetarët dhe ekonomitë marrin një pjesë të përfitimeve, motivimi politik i vendeve anëtare për të përfunduar procesin e zgjerimit mund të zbehet.

Prandaj, sfida për Shqipërinë nuk është vetëm të përfitojë nga integrimi gradual, por të sigurojë që ai të mbetet një etapë kalimtare drejt anëtarësimit të plotë dhe jo një destinacion përfundimtar. Në të kundërt, ekziston rreziku që Ballkani Perëndimor të mbetet në një “zonë gri” evropiane: më afër Bashkimit Evropian ekonomikisht, por ende jashtë tij politikisht dhe institucionalisht.

SHBA dhe Irani nënshkruajnë marrëveshjen historike për t'i dhënë fund luftës në Lindjen e Mesme



Pas më shumë se tre muajsh luftimesh që tronditën Lindjen e Mesme, ngritën çmimet globale të energjisë dhe rrezikuan përplasjen e drejtpërdrejtë mes fuqive rajonale, Shtetet e Bashkuara dhe Irani kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi që synon t'i japë fund konfliktit dhe të hapë rrugën për një marrëveshje përfundimtare mbi programin bërthamor iranian. Presidenti amerikan Donald Trump dhe presidenti iranian

Masoud Pezeshkian kanë nënshkruar dokumentin 14-pikësh, i cili hyri në fuqi menjëherë pas firmosjes. Marrëveshja u finalizua gjatë samitit të G7 në Francë dhe përbën zhvillimin më të rëndësishëm diplomatik mes Uashingtonit dhe Teheranit që prej marrëveshjes bërthamore të vitit 2015. Çfarë parashikon marrëveshja? Pika më e rëndësishme e memorandumit është ndalimi i menjëhershëm dhe i përhershëm i operacioneve ushtarake mes SHBA-së, Iranit dhe aleatëve të

tyre në të gjitha frontet, përfshirë edhe Libanin. Të dyja palët angazhohen të mos përdorin forcën kundër njëra-tjetres dhe të respektojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të shteteve të rajonit. Marrëveshja hap gjithashtu një periudhë 60-ditore negociatash intensive për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare mbi programin bërthamor të Iranit. Gjatë kësaj periudhe, Irani riafirmoi se nuk do të zhvillojë armë bërthamore dhe pranon bash-

këpunimin me Agjencinë Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (IAEA) për trajtimin e rezervave të uraniumit të pasuruar.

Hormuzi, pika kyçe e marrëveshjes

Një nga aspektet më të rëndësishme të dokumentit është rihapja e Ngushticës së Hormuzit, rrugës detare nga ku kalon afërsisht 20 për qind e tregtisë botërore të naftës dhe gazit të lëngshëm.

Irani angazhohet të garantojë kalimin e lirë dhe pa tarifa për anijet tregtare për të paktën 60 ditë, ndërsa SHBA nis heqjen graduale të bllokadës detare të vendosur gjatë luftës. Ekspertët vlerësojnë se ky element i marrëveshjes mund të ketë ndikimin më të menjëhershëm në ekonominë botërore, pasi tensionet në Hormuz kishin shkaktuar rritje të forta të çmimeve të energjisë dhe shqetësime për furnizimet globale.

Brenda pak orëve nga nënshkrimi i marrëveshjes, disa cisterna naftë rifilluan kalimin nëpër ngushticë, ndërsa çmimet ndërkombëtare të naftës shënuan rënie.

Lehtësim i madh ekonomik për Iranin

Në këmbim të angazhimeve të Teheranit, SHBA pranon të lehtësojë gradualisht regjimin e sanksioneve.

Dokumenti parashikon:

- Përfundim të menjëhershme që lejojnë eksportet iraniane të naftës.
- Zhbllokimin gradual të aseteve financiare iraniane të ngrira jashtë vendit.
- Heqjen e bllokadave ndaj porteve dhe anijeve iraniane.
- Negociata për eliminimin e plotë të sanksioneve amerikane



Kritikët vërejnë se dokumenti aktual nuk e detyron Iranin të çmontojë infrastrukturën bërthamore, nuk prek programin balistik iranian dhe nuk adreson drejtpërdrejt mbështetjen e Teheranit për grupet aleate në rajon. Për këtë arsye, shumë republikanë konservatorë dhe një pjesë e establishmentit të sigurisë në SHBA e konsiderojnë marrëveshjen si një kompromis të madh në favor të Iranit.

dhe ndërkombëtare në kuadër të marrëveshjes përfundimtare. Sipas tekstit të memorandumit, parashikohet gjithashtu krijimi i një plani investimesh dhe rindërtimi me vlerë të paktën 300 miliardë dollarë për ekonominë iraniane, një nga pikat më të debatueshme të marrëveshjes. Zyrtarët amerikanë kanë deklaruar se fondet mund të sigurohen nga vende të Gjirit Persik dhe investitorë ndërkombëtarë, por mekanizmi mbetet ende i paqartë.

Fitore diplomatike për Trump?

Marrëveshja po paraqitet nga Shtëpia e Bardhë si një sukses

i madh diplomatik i Donald Trump. Presidenti amerikan kishte deklaruar gjatë muajve të fundit se objektivi i tij ishte ndalimi i programit bërthamor iranian dhe rikthimi i stabilitetit në rajon.

Megjithatë, kritikët vërejnë se dokumenti aktual nuk e detyron Iranin të çmontojë infrastrukturën bërthamore, nuk prek programin balistik iranian dhe nuk adreson drejtpërdrejt mbështetjen e Teheranit për grupet aleate në rajon. Për këtë arsye, shumë republikanë konservatorë dhe një pjesë e establishmentit të sigurisë në SHBA e konsiderojnë marrëvesh-

DOKUMENTI PARASHIKON:

- ☐ Përjashtime të menjëhershme që lejojnë eksportet iraniane të naftës.
- ☐ Zhbllokimin gradual të aseteve financiare iraniane të ngrira jashtë vendit.
- ☐ Heqjen e bllokadave ndaj porteve dhe anijeve iraniane.
- ☐ Negociata për eliminimin e plotë të sanksioneve amerikane dhe ndërkombëtare në kuadër të marrëveshjes përfundimtare.

ane do të zhvillojnë negociata për:

- të ardhmen e programit bërthamor iranian;
- nivelin e pasurimit të uranimit;
- mekanizmat e inspektimit ndërkombëtar;
- heqjen e plotë të sanksioneve;
- zhbllokimin e aseteve iraniane;
- sigurinë afatgjatë në Gjirin Persik.

Nëse këto bisedime dështojnë, disa prej masave të marrëveshjes mund të pezullohen dhe tensionet mund të rrikthehen. Por nëse negociatat kanë sukses, dokumenti aktual mund të shndërrohet në marrëveshjen më të rëndësishme mes SHBA-së dhe Iranit në më shumë se një dekadë.

Për momentin, tregjet ndërkombëtare, vendet arabe të Gjirit, Evropa dhe Kina e kanë mirëpritur marrëveshjen, duke e konsideruar atë si shansin më të mirë për të shmangur një konflikt të ri rajonal dhe për të rikthyer stabilitetin në një nga zonat më të rëndësishme strategjike të botës.



jen si një kompromis të madh në favor të Iranit.

Pse Izraeli është i pakënaqur?

Marrëveshja shihet si një goditje politike për kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu.

Qeveria izraelite kishte kërkuar që lufta të vazhdonte deri në shkatërrimin e plotë të kapaciteteve bërthamore iraniane dhe dobësimin e rrjeteve aleate të Teheranit në rajon. Por memorandumit nuk përfshin asnjë angazhim për çarmatimin e plotë të Iranit dhe as garanci për ndërprerjen e

programit rakotor.

Burime diplomatike kanë bërë të ditur se tensionet mes administratës Trump dhe qeverisë izraelite u rritën gjatë ditëve të fundit të negociatave, sidomos pas sulmeve izraelite në Liban që rrezikuan rrëzimin e marrëveshjes.

Çfarë ndodh tani?

Nënshkrimi i memorandumit nuk përbën fundin e procesit diplomatik. Në fakt, ai është vetëm hapi i parë.

Brenda 60 ditëve të ardhshme, delegacionet amerikane dhe irani-

LUFTA QË GJEOGRAFIA REFUZOI TA HUMBTE

Si konflikti me Iranin ekspozoi kufijtë e fuqisë ushtarake dhe riktheu gjeografinë në qendër të politikës ndërkombëtare



Nga Marjana DODA

Kur Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli nisën operacionin ushtarak kundër Iranit më 28 shkurt, shumë analistë e konsideruan atë si përpjekjen më të rëndësishme të dekadave të fundit për të ndryshuar ekuilibrin politik të Lindjes së Mesme.

Objektivat zyrtare ishin ushtarake, si dobësimi i kapaciteteve strategjike të Iranit, neutralizimi i strukturave komanduese dhe kufizimi i aftësisë së Teheranit për të projektuar ndikim në rajon. Por pas këtyre objektivave qëndronte një synim

më i gjerë politik. Eliminimi i figurave kryesore të udhëheqjes dhe presioni i vazhdueshëm ushtarak pritej të krijonin kushtet për transformimin e sistemit politik iranian dhe, sipas disa vlerësimeve, edhe për rënien e Republikës Islamike. Tre muaj më vonë, rezultati është shumë më kompleks.

Një marrëveshje kornizë paqeje midis Uashingtonit dhe Teheranit ka ndalur përkohësisht përplasjen e drejtpërdrejtë. Megjithatë, pyetjet themelore që ngriti lufta mbeten ende pa përgjigje. Republika Islamike vazhdon të ekzistojë. Sistemi politik nuk u shemb. Pas eliminimit të Ali Khameneit, kalimi i pushtetit te Mojtaba Khamenei tregoi vazhdimësi institucionale

dhe jo shpërbërje të rendit politik. Në një farë mënyre, duket si një ripërtëritje të vetë regjimit. Kjo krijon paradoksin më të madh të konfliktit. Pra, një operacion që synonte, të paktën pjesërisht, dobësimin e pozitës strategjike të Iranit mund të ketë prodhuar efektin e kundërt: rritjen e rëndësisë së tij gjeopolitike.

Mësimi më i rëndësishëm i kësaj lufte nuk lidhet me teknologjinë ushtarake, me dronët, me inteligjencën artificiale apo me armët precize. Ai lidhet me një faktor shumë më të vjetër dhe shumë më të qëndrueshëm: gjeografinë.

RIKTHIMI I GJEOGRAFISË

Për një periudhë të gjatë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, mendimi strategjik ndërkombëtar u dominua nga ideja se teknologjia kishte zbehur rëndësinë e gjeografisë. Luftërat precize, mbikëqyrja satelitore, kapacitetet kibernetike dhe globalizimi ekonomik krijuan përshtypjen se vendndodhja fizike e shteteve po humbiste peshën e saj tradicionale.

Konflikti me Iranin dëshmoi të kundërtën.

Pak vende në botë gëzojnë një pozicion gjeografik kaq vendimtar sa Irani. Ai shtrihet në nyjën ku ndërthuren Gjiri Persik, Azia Qendrore, Kaukazi dhe Azia Jugore, ndërsa kontrolli mbi Ngushticën e Hormuzit i jep një rëndësi të veçantë në arkitekturën globale të energjisë. Gjatë konfliktit, vetëm mundësia e kufizimit të qarkullimit në Hormuz mjaftoi për të shkaktuar luhajtje të forta në tregjet energjetike, për të rritur kostot e sigurimeve detare dhe për të ngritur shqetësime në ekonominë më të mëdha të botës.

Kjo është arsyeja pse Irani nuk mund të trajtohet si një aktor rajonal i zakonshëm. Në fund të fundit, rëndësia strategjike e një shteti nuk matet vetëm nga madhësia e ekonomisë apo fuqia e ushtrisë së tij. Ajo matet edhe nga aftësia për të ndikuar në funksionimin e sistemit ndërkombëtar. Dhe në këtë aspekt, Irani mbetet një nga nyjet më të rëndësishme të rendit energjetik global.

Lufta tregoi se teknologjia mund të ndryshojë mënyrën se si zhvillohen konfliktet, por nuk mund të ndryshojë vendet ku përqendrohet rëndësia strategjike. Gjeografia vazhdon të imponojë kufij mbi fuqinë.



Pak vende në botë gëzojnë një pozicion gjeografik kaq vendimtar sa Irani. Ai shtrihet në nyjën ku ndërthuren Gjiri Persik, Azia Qendrore, Kaukazi dhe Azia Jugore, ndërsa kontrolli mbi Ngushticën e Hormuzit i jep një rëndësi të veçantë në arkitekturën globale të energjisë. Gjatë konfliktit, vetëm mundësia e kufizimit të qarkullimit në Hormuz mjaftoi për të shkaktuar luhajtje të forta në tregjet energjetike, për të ngritur shqetësime në ekonominë më të mëdha të botës.





DËSHIMI I LOGJIKËS SË NDRYSHIMIT TË REGJIMIT

Një tjetër mësim i konfliktit lidhet me kufijtë e forcës ushtarake si instrument për transformimin politik.

Që nga fundi i Luftës së Ftohtë, shumë ndërhyrje ushtarake janë mbështetur mbi supozimin se eliminimi i elitave politike ose dobësimi i aparatit shtetëror mund të prodhojë ndryshim regjimi. Përvoja e Irakut, Afganistanit dhe Libisë tregoi se realiteti është shumë më kompleks.

Lufta tregoi gjithashtu se Lindja e Mesme nuk është më një arenë ku ekuilibrat përcaktohen ekskluzivisht nga Uashingtoni. Prania ekonomike në rritje e Kinës dhe afërsia strategjike e Rusisë me Teheranin kanë krijuar një mjedis shumë më kompleks, ku interesat e fuqive globale ndërthuren me rivalitetet rajonale.

Konflikti me Iranin duket se e konfirmon sërish këtë përfundim.

Para luftës, Republika Islamike përballej me vështirësi ekonomike, pakënaqësi sociale dhe debate të brendshme mbi të ardhmen e vendit. Megjithatë, historia ka treguar se kërcënimet e jashtme shpesh prodhojnë efektin e kundërt nga ai që synohet.

Kur një shtet përballet me një rrezik ekzistencial, shoqëritë priren të bashkohen rreth institucioneve të tyre, ndërsa qeveritë fitojnë legjitimitet nga rezistenca dhe jo domosdoshmërisht nga performanca.

PIKËRISHT KJO DUKET SE NDODHI NË IRAN.

Vrasja e Ali Khameneit pritej nga shumë vëzhgues të shkaktonte një krizë të thellë pasardhjeje. Në vend të kësaj, sistemi politik demonstroi aftësi përshtatëse. Kalimi i pushtetit ndodhi pa shpërbërjen e institucioneve dhe pa kolapsin e rendit shtetëror.

Padiskutim, Irani nuk i shpëton pasojave të luftës. Megjithatë, objektivi politik më ambicioz, transformimi i sistemit mbetet i paarritur.

Në këtë kuptim, konflikti ngre pyetje serioze mbi aftësinë e ndërhyrjeve moderne për të prodhuar rezultate politike afatgjata.

KRIZA E ALEANCave

Pasojat e luftës nuk u kufizuan vetëm te Irani. Konflikti ekspozoi tensione të rëndësishme brenda vetë sistemit të aleancave që ka dominuar Lindjen e Mesme për dekada.

Për vendet e Gjirit Persik, lufta shërbeu si kujtesë se stabiliteti ekonomik i tyre mbetet i lidhur ngushtë me sigurinë rajonale. Pavarësisht partneritetit strategjik me Uashingtonin, shumë qeveri të rajonit kuptuan se asnjë garanci e jashtme nuk mund t'i mbrojë plotësisht nga pasojat e një konflikti të madh.

Si rezultat, tendenca për diversifikimin e marrëdhënieve strategjike ka gjasa të përshpejtohet. Bashkëpunimi me Kinën, afrimi me aktorë të tjerë rajonalë dhe politika më pragmatike ndaj rivalëve tradicionalë mund të bëhen pjesë e realitetit të ri të Gjirit.

Lufta tregoi gjithashtu se Lindja e Mesme nuk është më një arenë ku ekuilibrat përcaktohen ekskluzivisht nga Uashingtoni. Prania ekonomike në rritje e Kinës dhe afërsia strategjike e Rusisë me Teheranin kanë krijuar një mjedis shumë më kompleks, ku interesat e fuqive globale ndërthuren me rivalitetet rajonale. Si rrjedhojë, çdo krizë në Gjirin Persik nuk mund të shihet më vetëm si një çështje rajonale, por si pjesë e një loje më të gjerë gjeopolitike që shtrihet nga Mesdheu deri në Indo-Paqësor.

Po aq domethënëse janë tensionet që lufta nx-



ori në pah brenda vetë kampit perëndimor.

Evropa dhe SHBA-ja mbetën aleate, por jo domosdoshmërisht në të njëjtën gjatësi vale. Për shumë qeveri evropiane, rreziku i një konflikti të zgjatur nënkuptonte çmime më të larta të energjisë, presione ekonomike dhe pasiguri të reja gjeopolitike.

Kjo solli në sipërfaqe dallime strategjike që shpesh mbeten të fshehura në kohë paqeje.

IRANI, NJË FUQI E DOMOSDOSHME

Ndoshta pasoja më domethënëse e konfliktit nuk lidhet me territore të fituara apo të humbura, por me mënyrën se si ka ndryshuar pozicioni i Iranit në skenën ndërkombëtare. Lufta e ka rikthyer Teheranin në qendër të llogaritjeve strategjike globale, duke e shndërruar atë në një aktor me të cilin fuqitë rajonale dhe ndërkombëtare nuk mund të shmangin përballjen diplomatike.

Kjo nuk do të thotë se Irani del më i fortë në çdo aspekt. Përkundrazi, konflikti i ka imponuar kosto të konsiderueshme ekonomike dhe ushtarake. Por në politikën ndërkombëtare, rëndësia gjeopolitike nuk matet vetëm me fuqinë materiale. Ajo matet edhe me aftësinë për të ndikuar në zhvillime që shtrihen përtej kufijve kombëtarë.

Dhe pikërisht këtu qëndron ndryshimi. Nëse deri dje debati ndërkombëtar për Iranin përqendrohej kryesisht te programi bërthamor, sanksionet dhe rrjetet e tij të aleatëve në rajon, sot Teherani shihet si një faktor kyç në çështje shumë më të gjera, si sigurinë energjetike globale, lirinë e lundrimit në rrugët detare strategjike, stabilitetin e Gjirit Persik dhe ekuilibrat e rinj të fuqisë në Lindjen e Mesme.

Ky transformim ka ndryshuar edhe natyrën e debatit ndërkombëtar. Tre muaj më parë, pyetja kryesore ishte se si të ushtrohej presion mbi Iranin. Sot, pyetja është se si mund të ndërtohet një rend rajonal i qëndrueshëm pa përfshirjen e Iranit.

Përgjigjja duket gjithnjë e më e qartë. Asnjë formulë afatgjatë stabiliteti nuk mund të funksionojë pa përfshirjen e Teheranit.

Dhe kjo mund të jetë trashëgimia më e qëndrueshme politike e kësaj lufte.

RUSIA NË BOTËN MODERNE

Alexey Zaytsev

Ambasadori i Rusisë në Shqipëri

Përgjatë gjithë historisë së saj shumëshekullore, Rusia ka kaluar periudha sprovasash dhe tronditjesh, të cilat populli ynë i ka kapërcyer dhe është bërë më i fortë, më i bashkuar, duke u frymëzuar për arritje dhe fitore të reja.

Sot, Rusia, duke sfiduar botën e përqendruar te Perëndimi, është në ballë të luftës për formimin e një rendi të ri botëror shumëpopullar, më të drejtë dhe më të balancuar, duke ofruar një alternativë tjetër ndaj ambicieve neokoloniale të Perëndimit dhe modelit socio-kulturor që ai imponon.

Duke dashur të ruajë pozitat dominuese në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe parimet diskriminuese të shpërndarjes së pasurive natyrore, Perëndimi po ndërmerr një sërë përpjekjesh maksimale për të përmbajtur Rusinë.

Evropa po kërkon hapur të na shkaktojë një “disfatë strategjike” në fushën e betejës, po bën gjithçka të mundur për të zgjatur konfliktin në Ukrainë dhe po minon përpjekjet për paqe, pavarësisht faktit, nëse ato vijnë nga Moska, Uashingtoni apo kryeqytete të tjera.

Bashkimi Evropian po furnizon regjimin e Kievit me para dhe armë, duke zbatuar konceptin e “luftës deri në ukrainasin e fundit”. Kuptohet, që e gjithë kjo bëhet në kurriz të taksapaguesve evropianë, pa marrë parasysh



problemet ekonomike në rritje dhe rënien e standarteve të jetesës së popullsisë. Nën sloganin e trilluar të një kërcënimi rus ka nisur një program militarizimi i industrisë, i paparë që nga Lufta e Dytë Botërore. Po kërkohen zgjidhje të rafinuara për të organizuar sa më mirë rrëmbimin e paligjshëm të aseteve financiare ruse të ngrira. Kundër Rusisë janë vendosur më shumë se 30 mijë sanksione, më shumë se kundër Koresë së Veriut, Iranit dhe Sirisë të marra së bashku. Juridiksionet perëndimore kanë bllokuar rezervat sovraane ruse në shumën prej rreth 300 miliardë dollarë amerikanë, kanë vendosur sanksione ndaj institucioneve financiare, kanë shkëputur sistemin bankar

rus nga sistemet ndërkombëtare të transmetimit të të dhënave, kanë vendosur ndalime dhe kufizime të shumta në furnizimin me lëndë të para, mallra dhe teknologji për në Rusi dhe jashtë saj, dhe kanë vendosur kufizime të shumta personale për qytetarë rusë. Së fundmi, Perëndimi ka kaluar në të ashtuquajturat sanksione dytësore, nga të cilat vuajnë edhe vendet e treta.

Por shpresat se sanksionet do të vepronin menjëherë, se ekonomia ruse do të binte në kolaps dhe shoqëria do të destabilizohej, nuk u justifikuan. Pavarësisht presionit të paprecedentë nga jashtë, vendi ynë mbetet një fuqi dinamike në zhvillim me tregues makroekonomikë të qëndrueshëm.

Flukset e tregtisë së jashtme janë riorientuar dhe transaksionet ndërkombëtare janë konvertuar në valutën kombëtare. Rritja e PBB-së gjatë tre viteve të fundit tejkaloi 10%. Industria është ristrukturuar dhe po zbaton një program të zëvendësimit të importit.

Pavarësisht presionit nga jashtë, Rusia sot po realizon një kompleks të tërë projektsh kombëtare në shkallë të gjerë në fushën sociale dhe demografike, që i dedikohen forcimit të institucionit të familjes, mbështetjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit të kujdesit shëndetësor dhe rritjes së jetëgjatësisë.

Viti 2026 u shpall nga Presidenti V.V.Putin si Viti i Bashkimit të Popujve të Rusisë. Kjo mishëron angazhimin e shtetit në mbështetje të kulturës, gjuhës dhe identitetit të popujve që banojnë në

vendin tonë, duke simbolizuar unitetin qytetar të shtetasve rusë, pavarësisht rajonit, ku jetojnë.

Në kuadrin e forcimit të sovranitetit teknologjik janë hartuar dhe po zbatohen programe për zhvillimim e ekonomisë së të dhënave, transformimin dixhital të shtetit, robotizimin e prodhimit, krijimin e një baze të pavarur komponentësh për industrinë, subvencionimin e prodhimit të dronëve civilë dhe komercialë.

Një vëmendje e madhe po i kushtohet projektit kombëtar “Infras-truktura për Jetën”, e cila parashi-kon modernizimin e shërbimeve publike dhe arritjen e një niveli cilësisht të ri të zhvillimit urban.

Në shkallë me të vërtetë kontinentale janë drejtimet prioritare në infrastrukturën e transportit: zhvillimi i korridorit “Veri-Jug”, zgjerimi i Sistemit Hekurudhor Lindor, i cili përfshin Hek-

urudhat Trans-Siberiane dhe Bajkal-Amur, zhvillimi i Rrugës Detare Veriore. Këto akse transporti po ndikojnë tashmë në konfigurimin e logjistikës globale.

Përpyekjet e Perëndimit për të izoluar Rusinë në arenën ndërkombëtare dështuan. Pavarësisht stimulimit të ndjenjave rusofobe dhe përpyekjeve të pandërprera për të njollosur imazhin e vendit tonë, ai po forcon rolin e tij si një pjesëmarrës aktiv dhe i rëndësishëm i komunitetit ndërkombëtar, ai ka fituar pozita kyçe në organizatat ndërkombëtare dhe si anëtar themelues i OKB-së mbështet parimet e Kartës së saj. Një vëmendje e madhe i kushtohet bashkëpunimit në bashkimet integruese rajonale dhe botërore. Vit pas viti po rritet rëndësia dhe pesha e BRICS – hallka kryesore në ndërtimin e një rendi të ri botëror shumëpolar.

Një theks i rëndësishëm po i vihet zhvillimit të bashkëpunimit brenda SCO-së, EAEU-së, CIS-së dhe CSTO-së, të cilën Moska e kryeson këtë vit. Në të gjitha forumet e disponueshme, ne vazhdimisht mbështesim zhvillimin e bashkëpunimit të barabartë dhe me dobi të ndërsjellë, si dhe krijimin e një arkitekture sigurie të barabartë dhe të pandashme.

Sot, Rusia po zgjeron në mënyrë aktive kontaktet e saj me partnerë konstruktivë në të gjithë botën. Një nga prioritetet e politikës së jashtme të vendit tonë është bashkëveprimi me vendet e Jugut Global, të cilave u ofrojmë një dialog ndërqytetëruës në vend të qasjes neokolonialiste.

Panjë Rusi të fortë, sovranë, krijimi i një rendi botëror të ekuilibruar dhe të drejtë është i pamundur sot.



Pavarësisht presionit nga jashtë, Rusia sot po realizon një kompleks të tërë projektsh kombëtare në shkallë të gjerë në fushën sociale dhe demografike, që i dedikohen forcimit të institucionit të familjes, mbështetjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit të kujdesit shëndetësor dhe rritjes së jetëgjatësisë.

“Nga ‘agjentët e huaj’ te ‘fashistët’: Kush janë në të vërtetë protestuesit?”



Në demokraci, protesta është një e drejtë. Në demokraci, qytetari që kundërshton qeverinë nuk është armik. Por në Shqipërinë e vitit 2026, kryeministri Edi Rama duket se po ndërton një tjetër narrativë, atë të protestuesit si kërcënim.

Fillimisht ishin “agjenturat e huaja”. Më pas erdhën insinuatat për interesa serbe, ruse e greke. Në vijim

u fol për ndikime iraniane, për “luftë hibride”, për duar të fshehta që vepronin nga jashtë kufijve të Shqipërisë. Më vonë protestuesit u akuzuan se po dëmtonin turizmin dhe ekonominë e vendit. Sot, sipas vetë kryeministrit, në protesta qenka shfaqur edhe një “frymë fashiste”.

Vetëm pak ditë më parë, Rama deklaroi se protestat po dominohen nga një frymë që nuk pranon mendimin ndryshe dhe e krahasoi atë me fillesat e lëvizjeve fashiste dhe naziste në Europë.

Së fundmi, kryeministri Edi Rama deklaroi se brenda protestës ekziston “një komponentë fashiste, një frymë fashiste”, duke argumentuar se ajo shfaqet te ata që, sipas tij, nuk pranojnë mendimin ndryshe dhe ushtrojnë presion ndaj qytetarëve që nuk i bashkohen protestës.

Por lind një pyetje e thjeshtë: a ndihmon demokracinë etiketimi i një proteste me terma si “frymë fashiste”, “agjencia të huaja” apo instrumente të interesave të jashtme?

Në vend që të dëgjojë arsyet e protestës, kryeministri duket se ka zgjedhur të delegjitimojë protestuesit. Në vend që të debatojë me argumente, ai debaton me etiketa. Dhe historia na mëson se kur pushteti fillon të shohë armiq te qytetarët e vet, problemi nuk është më te protesta, por te vetë pushteti.

Madje, përmes kësaj narrative, Rama rrezikon të

Kryeministri Edi Rama deklaroi se brenda protestës ekziston “një komponentë fashiste, një frymë fashiste”, duke argumentuar se ajo shfaqet te ata që, sipas tij, nuk pranojnë mendimin ndryshe dhe ushtrojnë presion ndaj qytetarëve që nuk i bashkohen protestës. Por lind një pyetje e thjeshtë: a ndihmon demokracinë etiketimi i një proteste me terma si “frymë fashiste”, “agjencia të huaja” apo instrumente të interesave të jashtme?



thellojë një përçarje të re në shoqërinë shqiptare. Kur protestuesit etiketohen si “fashistë”, “nazistë”, “agjentë” apo vegla të interesave të huaja, përcillet mesazhi se një pjesë e shqiptarëve përbën kërcënim për pjesën tjetër. Kjo logjikë e ndarjes mes “ne” dhe “atyre”, por minon vetë themelet e bashkëjetesës demokratike.

Por kush janë këta njerëz që dalin çdo mbrëm-

je në bulevard? Janë studentë, pedagogë, prindër, pensionistë, profesionistë, artistë dhe sipërmarrës. Disa mund të jenë votues të opozitës. Të tjerë mund të kenë votuar Partinë Socialiste. Shumë prej tyre janë thjesht qytetarë të zhgënjyer që kërkojnë të dëgjohen. Ata nuk pushojnë së qeni qytetarë vetëm sepse kundërshtojnë qeverinë. Nuk bëhen fashistë sepse protestojnë. Nuk bëhen agentë sepse kërkojnë llogari. Nuk bëhen armiq sepse kërkojnë një Shqipëri më të drejtë.

Shqipëria ka nevojë për më shumë dialog dhe më pak etiketime. Ka nevojë për më shumë dëgjim dhe më pak demonizim. Sepse një kryeministër nuk duhet të ndërtojë mure mes shqiptarëve, por ura komunikimi mes tyre.

Protestuesit mund të kenë të drejtë ose mund të gabojnë. Mund të kenë zgjidhje ose jo. Por ata nuk pushojnë së qeni qytetarë vetëm sepse kundërshtojnë qeverinë. Ata nuk bëhen fashistë sepse protestojnë. Nuk bëhen agentë sepse kërkojnë llogari. Nuk bëhen armiq sepse kërkojnë një Shqipëri më të drejtë. Në fund të fundit, protesta nuk është kërcënim i demokracisë. Protesta është një nga provat që demokracia ende jeton. Dhe kur mijëra qytetarë dalin në rrugë me flamurin kuqez në duar, pyetja që duhet të shtrojë çdo qeveri nuk është “kush i dërgoi?”, por “pse kanë ardhur?”.

Protestuesit mund të kenë të drejtë ose mund të gabojnë. Mund të kenë zgjidhje ose jo. Por ata nuk pushojnë së qeni qytetarë vetëm sepse kundërshtojnë qeverinë. Ata nuk bëhen fashistë sepse protestojnë. Nuk bëhen agentë sepse kërkojnë llogari. Nuk bëhen armiq sepse kërkojnë një Shqipëri më të drejtë. Në fund të fundit, protesta nuk është kërcënim i demokracisë. Pyetja që duhet të shtrojë çdo qeveri nuk është “kush i dërgoi?”, por “pse kanë ardhur?”.

Maskirovka Ballkanike: Pse “distancimi” i Moskës është vetëm një operacion për mbijetesën e regjimit të Vuçiçit

Autor: Dr. Gurakuç Kuçi – Profesor në Kolegjin Universum dhe bashkëpunor i jashtëm në ISLH “OCTOPUS”



Hapi i radhës për konsolidimin e pushtetit të Vuçiçit në Serbi u shënuar nga Dmitry Peskov përmes një operacioni klasik Maskirovka. Zëdhënësi i Kremlinit deklaroi se “Orbani kurrë nuk ka qenë miku ynë... dhe as Vuçiçi nuk është i tillë”, duke shtuar se “kemi marrëdhënie historike, por ata janë vend i pavarur”. Megjithatë, ai theksoi partneritetin midis Rusisë dhe Serbisë, të diskutojnë çështjet

më urgjente.

theksimi i partneritetit për çështje urgjente e zhvesh këtë deklaratë nga çdo natyrë diplomatike, duke e shndërruar në një përpjekje për të hequr etiketën e “vasalit rus” nga figura e Vuçiçit në sytë e opinionit publik ndërkombëtar.

DISTANCIMI SI A NATOMI MASHTRIMI

Regjimi në Beograd e di se çelësi i mbijetesës në vitet në

vijim është shmangia e një përplasjeje frontale me Brukselin dhe Uashingtonin. Deklarata e Peskovit i shërben këtij qëllimi, duke i ofruar perëndimit një narrativë të dobishme: “Ja, Rusia po distancohet, Serbia po orientohet drejt pavarësisë, prandaj le ta mbështesim Vuçiçin për të shmangur destabilizimin”.

Kremlini nuk dëshiron të përsërisë “skenarin e Hungarisë”. Mosdistancimi i hapur ndaj

Kremlini nuk dëshiron të për-sërisë “skenarin e Hungarisë”. Mosdistancimi i hapur ndaj Orbanit ashpërsoi kundërshtarët e tij; Moska po zbaton një qasje të kundërt me Vuqiçin për të shmangur të njëjtin fat. Ky cikël “neutraliteti” është një metodologji e përsëritur që nga viti 2014: sa herë që presioni perëndimor rritet, Rusia lëshon një deklaratë “neutraliteti”, Vuqiç e përdor atë për të fituar kohë, dhe nën këtë “tymnajë”, regjimi konsolidohet.



Orbanit ashpërsoi kundërshtarët e tij; Moska po zbaton një qasje të kundërt me Vuqiçin për të shmangur të njëjtin fat. Ky cikël “neutraliteti” është një metodologji e përsëritur që nga viti 2014: sa herë që presioni perëndimor rritet, Rusia lëshon një deklaratë “neutraliteti”, Vuqiç e përdor atë për të fituar kohë, dhe nën këtë “tymnajë”, regjimi konsolidohet.

Emërimi i Andjiqit si njeriu i Rusisë në arterien e industrisë ushtarake në Serbi Përderisa Peskov flet për “marëdhënie historike” dhe “vende të pavarura”, realiteti operacional lëviz në një drejtim krejt tjetër. Emërimi i Milosh Andjiqit në krye të Jugoimport SDPR është fakti tjetër që shkatër-

ron narrativën e distancimit. Jugoimport SDPR nuk është një kompani e zakonshme, por arteria kryesore e tregtisë së armëve dhe teknologjisë ushtarake të Serbisë. Vendosija e një njeriu të lidhur ngushtë me Aleksandar Vulinin (i cili është i sanksionuar nga SHBA-ja dhe i lidhur me shërbimet ruse) në këtë pozicion, dëshmon se koordinimi ushtarak dhe inteligjent me Moskën po forcohet, jo po dobësohet. Kjo është një armatosje e strukturave kryesore për ta bërë regjimin imun ndaj ndryshimeve politike.

STRATEGJIA E TRI SHTYLLAVE DHE BLINDIMI I PUSHTETIT
Vuqiç po aplikon një strategji

mbijetese të bazuar në tri shtylla:

1. Kina për kapital dhe investime;
2. Rusia për siguri dhe inteligjencë;
3. Perëndimi për legjitimitet, përmes metodave të Maskirovka-s.

Për regjimin, nuk ka më rëndësi se kush e mban postin, por kush i tërheq fijet. Struktura është blinduar; pjesa tjetër është thjesht teatër. Distancimi publik është mjet për të shuar çdo reagim perëndimor. Nëse Perëndimi bie pre e këtij mashtrimi, Serbia do të mbetet një “Black Box” ku Rusia dhe Kina kanë akses, ndërsa Brukseli financon qëndrueshmërinë e këtij sistemi.

Këto çështje duhen parë gjithmonë me kujdes; assesi nuk duhet rënë pre e veprimeve Maskirovka.

Të jesh antiglobalist s'do të thotë të jesh anti-amerikan!

(RASTI I DEBATIT PËR GAZIN AMERIKAN NË KOSOVË)



Prof. Dr. Fadil Maloku

Sociolog

Nëse do t'i analizonim si pozicionimet ashtu edhe deklaratimet qeveritare dhe ato opozitare kosovare rreth çështjes së lidhjes së Kosovës me gazin amerikan, që mori publicitet edhe në fushatë, por edhe në mediet sociale, paraprakisht duhet t'i sqarojmë disa paranteza.

Së pari, sa kam kuptuar nga këndvështrimi i një njohësi të

proceseve dhe zhvillimeve globale, rezervat e qeverisë aktuale nuk kanë të bëjnë aq me ndonjë refuzim kategorik të projektit, sa me dyshimet që ajo, si qeveri e majtë, i ka ndaj Korporatave Transnacionale (KTN-ve). Duket se këto dyshime dhe rezerva janë më shumë të natyrës së një fobie politike, madje edhe shprehje e një paradigme antiglobaliste, sovraniste dhe skeptike ndaj kapitalit transnacional. Ndërkaq, të qenit sot antiglobalist nuk do të thotë domos-

doshmërisht të kesh edhe qëndrim anti-amerikan.

Së dyti, ky interpretim kërkon disa nuanca e shpjegime sociologjike, ngase opozita projektin e gazit amerikan kryesisht po e percepton përmes prizmit të forcimit të partneritetit strategjik me SHBA-në, pastaj përmes procesit të diversifikimit të burimeve energjetike, si dhe reduktimit të varësisë nga prodhimi tradicional energjetik që ka për bazë thëngjillin. Nga kjo perspektivë, avokimi i një projekti



të tillë nga opozita paraqitet i kuptueshëm dhe tejet shqetësues, sepse ai nuk duhet parë vetëm si interes energjetik, por edhe si interes gjeostrategjik për Republikën tonë. Në anën tjetër, ky projekt, në këtë kohë krize, na dëshmon se lidhja e interesave ekonomike ndërmjet shteteve dhe vendeve krijon edhe kushte e interesa gjeopolitike.

Së treti, problemi qëndron në faktin se qeveria aktuale, e njohur si e majtë, këtë tematikë nuk

po e trajton përmes “dioptrisë” së opozitës, por përmes një logjike tjetër, asaj ideologjike. Tani, kur një logjikë e tillë ndërlihet me diskursin e saj publik, shanset për t’u konceptuar, ndër të tjera, si mosbesim ndaj Korporatave Transnacionale (KTN-ve), pastaj si frikë nga ndërhyrja dhe kontrolli i shtuar mbi institucionet e shtetit dhe, sidomos, si shqetësim për krijimin e varësive afatgjata me rreziqe potenciale për sektorët strategjikë, janë më se reale.

Dhe ky pozicionim, në sociolog-

jinë e globalizimit, të cilën e ligjëroj tash e gati dy dekada, njihet si “skepticizëm ndaj globalizimit neoliberal”, pra si dyshim ndaj modelit në të cilin kompanitë shumëkombëshe fitojnë rol dominues në ekonomitë e shteteve të vogla. Së këndejmi, pa dashur ta amnistoj apo avokoj as qeverinë e as opozitën, më korrekte dhe më e saktë do të ishte të thuhej se pozicioni qeveritar është më shumë antiglobalist sesa anti-amerikan. Themi kështu, sepse ajo në prononcimet e saj publike nuk e ka kontestuar, të paktën publikisht, as aleancën strategjike me SHBA-në, as praninë e NATO-s, e as partneritetin politik me institucionet amerikane. Ajo që është kontestuar, edhe publikisht, ka qenë kryesisht modeli i investimeve dhe frika nga ndikimi i kapitalit transnacional në sektorë të caktuar strategjikë të shtetit të Kosovës.

Së katërti, ky qëndrim qeveritar, që në fakt është një pozicion disi dykuptimësh, të cilin në formë të ndryshme e gjejmë edhe te lëvizjet e majta evropiane, por edhe te disa rryma konservatore sovraniste, të cilat e mbështesin Perëndimin politikisht, ndërsa e kritikojnë globalizimin e tij ekonomik. Në fakt, globalizimi ekonomik, i cili pas rikthimit të Donald Trump në skenën politike amerikane po përballë me sfida tejet serioze dhe me një pasiguri të shtuar për drejtimin e tij të ardhshëm, po hyn gradualisht në një fazë të re rikonfigurimi, ku sovranizmi ekonomik dhe proteksionizmi po rikthehen si alternativa të

“

Avokimi i një projekti të tillë nga opozita paraqitet i kuptueshëm dhe tejet shqetësues, sepse ai nuk duhet parë vetëm si interes energjetik, por edhe si interes gjeostrategjik për Republikën tonë. Në anën tjetër, ky projekt, në këtë kohë krize, na dëshmon se lidhja e interesave ekonomike ndërmjet shteteve dhe vendeve krijon edhe kushte e interesa gjeopolitike.



besueshme politike. Kjo është arsyeja pse skepticizmi ndaj globalizimit nuk është më vetëm “monopol” i së majtës politike, por po shfaqet gjithnjë e më shumë edhe në qarqe të caktuara konservatore dhe nacional-sovraniiste në botën e sotme. Megjithatë, kur përdorim togfjalëshin anti-amerikanizëm, ne nënkuptojmë kundërshtimin e drejtpërdrejtë ndaj SHBA-së si fuqi politike, ekonomike, ush-

tarake, kulturore dhe gjeostrategjike. Pikërisht në këtë kuptim është trajtuar roli global i Amerikës edhe nga sociologu dhe politologu i njohur amerikan, Zbigniew Brzezinski. Paradoksi dhe keqkuptimi qëndrojnë në faktin se në Kosovë shpeshherë çdo mospajtim me ndonjë projekt amerikan ngatërrohet dhe interpretohet automatikisht si anti-amerikanizëm.

Së pesti, nëse e abstrahojmë

çështjen e refuzimit të projektit të gazit amerikan nga qeveria e Kosovës, mund të thuhet se ai më tepër reflekton një kulturë politike sovraniste dhe antiglobaliste, e cila shfaq rezerva dhe mosbesim ndaj rolit të korporatave transnacionale në sektorët strategjikë të shtetit.

P.S. Sfida kryesore për Kosovën, në gjykimin tim, mbetet nëse një qasje e tillë arrin ta ruajë sovranitetin ekonomik pa cenuar perceptimin e partneritetit strategjik me SHBA-në. Pikërisht në këtë pikë ndodhet edhe ajo dilema “hamletiane”: si të balancohet nevojja për autonomi ekonomike me domosdoshmërinë e ruajtjes së aleancës strategjike me Amerikën, në një botë ku asgjë nuk është ashtu siç ishte në vitin 1999...

Kur përdorim togfjalëshin anti-amerikanizëm, ne nënkuptojmë kundërshtimin e drejtpërdrejtë ndaj SHBA-së si fuqi politike, ekonomike, ushtarake, kulturore dhe gjeostrategjike. Pikërisht në këtë kuptim është trajtuar roli global i Amerikës edhe nga sociologu dhe politologu i njohur amerikan, Zbigniew Brzezinski.

Në Tivat na morën me të mirë! Paqe i thënçin! Ujdi po, paqe jo! Po BE/ SHBA ku janë ? 5 zgjedhje, asnjë zgjidhje!

REAL POLITIK NR. 127 | 1 - 15 QERSHOR 2026 | EXCLUSIVELY FOR ARGUMENTUM

Komente "flash" mbi 5 ngjarjet kryesore diplomatike, shqip dhe shkurt, vetëm me 1000 fjalë nga analisti i njohur, Mjeshtër i Madh në Diplomaci



DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*

1.

Në Tivat na muarën me të mirë !

Kështu mund të thuhet për Samitin BE- Ballkani Perendimor në Tivat, Mali i Zi më 5 Qershor. I paraprirë nga turi ballkanik më 1 - 4 Qershor i Presidentit të Këshillit European Antonio Costa dhe propozimi i njohur franco-gjerman për integrimin gradual të vendeve tona në BE bashkë me shtimin e masave mbrojtëse kundër vendosjes së vetove të mundshme dhe përfitime të ndryshme ekonomike në rastin e përparimit në mbylljen e kapitujve përkatës. Në fakt, e donte situata gjeopolitike dhe vetë gjendja brenda BE-së,

që kjo e fundit "të na merrte me të mirë" në këtë Samit. U thanë fjalë të bukura, u soll shembulli i Malit të Zi si vendi i parë që pritet të anëtarësohet në BE më 2028. Gjithsesi, asgjë nuk është e qartë dhe e sigurt derisa BE-ja të vendosë përfundimisht. Ndaj nuk ka vend për eufori as për ne, sepse edhe ky integrim gradual dhe

Nuk ka vend për eufori as për ne, sepse edhe ky integrim gradual dhe jo i plotë nuk do të bëhet aforfe, por vetëm mbi bazën e meritave në realizimin e reformave dhe kushteve të kërkuara nga BE-ja, sidomos lidhur me shtetin e të drejtës dhe luftën kundër korrupsionit, të cilat janë edhe " Thembra jonë e Akilit". Urojmë që premtimet e BE-së në Tivar të mos jenë " fjalë të mira por gurë në trastë".

jo i plotë nuk do të bëhet aforfe, por vetëm mbi bazën e meritave në realizimin e reformave dhe kushteve të kërkuara nga BE-ja, sidomos lidhur me shtetin e të drejtës dhe luftën kundër korrupsionit, të cilat janë edhe " Thembra jonë e Akilit". Urojmë që premtimet e BE-së në Tivar të mos jenë " fjalë të mira por gurë në trastë".

2.

Paqe i thëncin! Është ajo që po "gatuhet" në kuzhinat politike europiane lidhur me marrëveshjen e mundshme të paqes me Rusinë. Më 7 Qershor në Londër u mbledhën Starmer, Merz dhe Macron, të cilët paraqitën një plan me pesë pikat e njohura për paqe në Ukrainë. Mirëpo, duket qartë se Rusia nuk do paqe të vërtetë por kapitullimin e Ukrainës dhe të Europës. Sepse ajo vazhdon të kërkojë një Ukrainë Pa ushtri, Pa NATO, Pa Trupa të huaja sigurie dhe Pa territoret e vitit 2014. Ndaj, edhe pse Moska po pëson disfata në frontin e luftës, është naivitet të besosh paqen e saj. Madje, ajo po mat pulsën e NATO-s, nëse do të zbatonte Nenin 5 për mbrojtjen kolektive nëse ajo sulmon një vend të NATO-s. E nxitur edhe nga tërheqja graduale ushtarake amerikane nga Europa. Tanimë është e qartë se Paqja e vërtetë arrihet vetëm me luftë dhe përparimin e Ukrainës, siç edhe po ndodh, me suksese tashmë të njohura modeste por tejet inkurajuese.

3.

Ujdi po, paqe jo! Më në fund, më 19 Qershor në Gjenevë do të nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit midis SHBA-ve dhe Iranit, me shpresë që t'i çelë rrugën paqes në rajon. Padyshim ngjarje e madhe ku sipas CNN, Trump paralajmëroi arritjen e kësaj ujdije plot 40 herë! SHBA-të bombarduan, bllokuan dhe bullizuan Iranin me synim pëmbysjen e Mullahëve, vendosjen e paqes, dorëzimin e uraniumit të pasuruar dhe heqjen dorë nga armët bërthamore. Por deri tani



asnjë nga këto synime nuk u realizua dhe gjithçka ka mbetur pezull. Sepse ende nuk ka një marrëveshje klasike, por kornizë



Fakt është se megjithë premtimet e bujshme, ende nuk ka dhe vështirë të realizohet një marrëveshje më të mirë për SHBA-të se ajo e Obamës me aleatët europiane dhe Teheranin në vitin 2015. Megjithatë, kjo ujdi i duhej tmerrësisht Trumpit. Se brenda vendit ziejnë debatet dhe pakënaqësia ndaj tij, inflacioni kaloi 4 për qind, çmimet e karburantit dhe energjisë janë në tavan.



e hapur për diskutime të mëtejshme në 60 ditët e ardhëshme. Dhe askush nuk e di se si do rrjedhin punët. Fakt është se megjithë premtimet e bujshme, ende nuk ka dhe vështirë të realizohet një marrëveshje më të mirë për SHBA-të se ajo e Obamës me aleatët europiane dhe Teheranin në vitin 2015. Megjithatë, kjo ujdi i duhej tmerrësisht Trumpit. Se brenda vendit ziejnë debatet dhe pakënaqësia ndaj tij, inflacioni kaloi 4 për qind, çmimet e karburantit dhe energjisë janë në tavan. Kryesorja, zgjedhjet e Mesmandatit nuk janë as 5 muaj larg dhe parashikimet për Republikanët nuk janë të mira. Ja pse kjo Ujdi, edhe pse nuk zgjidh shqetësimet themelore me Iranin ishte domosdoshmëri imperative për mbijetesën politike të Trumpit dhe Republikanëve. Ndaj deri tani, mund të thuhet se kemi " Ujdi, po, por paqe jo !



4.

Po BE/ SHBA ku janë ? Kaluan mbi dy javë që në Tiranë po zhvillohet në përmasa masive të papara deri tani Protesta madhështore qytetare paqësore dhe gjithëpërfshirëse. E shoqëruar me tubime të mëdha kudo në Shqipëri dhe në diasporë në metropolet më të rëndësishme botërore. E përcjellë “live” nga rrjetet më të mëdha televizive botërore. Një protestë vërtet model edhe për Europën dhe SHBA-të. Mirëpo, çuditërisht BE dhe SHBA deri tani kanë qëndruar “memecë”, pa asnjë fjalë, asnjë qëndrim, asnjë dekaratë! Si qytetar por edhe ish diplomat në Bruksel nuk e shpjegoj dot këtë qëndrim indiferent perendimor, sidomos nga BE-ja. Ndoshta kanë vështirësi mbasi deri tani për hir të stabilitetit e kanë përkëdhelur qeverinë dhe Ramën; ndaj e kanë të vështirë të marrin kthesën. Gjithsesi, asnjë problem nuk ka për Brukselin dhe

Uashingtonin që ta përshëndetin këtë protestë, karakterin e saj paqësor që ata e kanë patur shumë merak më parë dhe të bëjnë thirrje për dialog dhe zgjidhje mes palëve. E çfarë i pengon ata për aq gjë? Urojmë që kjo heshtje të marrë fund sa më parë, se nuk i bën nder as SHBA-ve dhe ca më pak BE-së.

5.

5 zgjedhje, asnjë zgjidhje! Më 7 Qershor në Kosovë u zhvilluan zgjedhjet e reja parlamentare. Të dytat brenda 6 muajve dhe të pestat në 7 vitet e fundit! Këtë radhë, siç dihet u bënë pas dështimit të konsensusit për zgjedhjen e Presidentes së Republikës. Një dështim i paralajmëruar, edhe pse u përdorën të gjitha truket ligjore, u shty afati edhe dy muaj, por prapë asgjë. Pra PESE palë zgjedhje por Pa ASNJE zgjidhje. Mirëpo ZGJEDHJET nuk bëhen për t'u kthyer në ZGJEDHE, por për ZGJIDH-

JE, madje të qëndrueshme. Kjo tregoi sërish dështimin e klasës politike në Kosovë, çka ia ul asaj prestigjin dhe imazhin; për pasojë. Pasojat janë të rënda për progresin e Kosovës, njohjen e saj ndërkombëtare dhe integrimin në BE/ NATO. Ca më keq në një kohë rreziqesh dhe kërcënimesh nga Serbia.

E keqja më e madhe është se këto zgjedhje e ndërlikojnë më shumë situatën për emërimin e qeverisë dhe Presidentit të Republikës. Ndaj, politika në Kosovë lipset të ndërgjegjësohet se zgjidhja nuk qëndron vetëm te numrat por te vullneti politik, toleranca, mirëkuptimi, besimi dhe kompromisi demokratik. Po, ato mund të jenë të hidhura dhe me kosto për politikanët dhe partitë, por janë rruga e vetme e zgjidhjes. Ndaj politika në Prishtinë të mos vazhdojë më “business as usual” Përkundrazi, në vend të zgjedhjeve të parakohshme, të kërkojë zgjidhje të përhershme.

Rama për “Financial Times”: Unë nuk jam kumbari i Shqipërisë



Në një intervistë për prestigjiozen “Financial Times”, kryeministri Edi Rama ka mohuar akuzat se është kumbari i Shqipërisë, pas javësh protestash kundër korrupsionit të nxitura nga projekti për një resort luksoz i lidhur me Jared Kushner, dhëndrin e presidentit amerikan, Donald Trump. I ashtuquajtur “Revolucioni i flamingove” u nxit nga zemërimi publik ndaj projektit prej katër miliardë dollarësh të planifikuar nga Jared Kushner dhe Ivanka Trump në një ishull dhe pranë një zone të mbrojtur natyrore, e

njohur për flamingot e saj. Protestuesit kanë kërkuar dorëheqjen e Ramës dhe ndjekjen e tij penale për atë që e konsiderojnë korrupsion sistematik që u lejon investitorëve ndërkom-bëtarë të ndërtojnë në zona të mbrojtura.

”Njerëzit thonë se unë jam udhëheqësi i gjithë kësaj. Unë u them shkofshi në djall. Kaq e thjeshtë është”, tha Rama.

”Nuk është detyra ime të provoj se nuk jam unë kumbari; është detyra e tyre të provojnë se jam”, shton ai.

Prokurorët shqiptarë kanë lësh-

uar urdhërarreste për dhjetëra biznesmenët të akuzuar për trafik droge dhe pastrim parash, përfshirë një person që më parë kishte qenë pronar toke në zonën ku do të zhvillohet projekti i Kushnerit dhe bashkëshortes së tij, Ivanka Trump.

Një zëdhënës i Kushnerit dhe partnerëve të tij në Shqipëri nuk iu përgjigj kërkesave për koment. Rama këmbënguli se investimet e Kushnerit janë të rregullta dhe se nuk ekziston asnjë lidhje mes projektit dhe hetimit ndaj ish-pronarit të tokës.

”Të thuash se ekonomia shqip-

tare bazohet te pastrimi i parave është e tmerrshme”, tha Rama nga zyra e tij, me pamje nga bulevardi ku dhjetëra mijëra njerëz kanë protestuar çdo mbrëmje për më shumë se tre javë.

”Pastrimi i parave është pjesë e ekonomisë sonë, por nuk është një problem kaq i madh”, shtoi ai. ”Mendoni se nuk ka pastrim parash në Londër? Ka. Por a mund të thuhet se ekonomia britanike mbështetet në masë të madhe te pastrimi i parave? Jo”, shton ai.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka lëshuar urdhërarreste për 20 biznesmenë, të cilët dyshohen se janë përfshirë në trafik ndërkombëtar droge dhe pastrim parash. Sipas hetimeve, miliarda euro dyshohet se janë kanalizuar drejt projekteve të mëdha të ndërtimit përgjatë bregdetit Adriatik dhe në kryeqytetin shqiptar.

Ndër biznesmenët e përfshirë është edhe Artur Shehu, shtetas shqiptaro-amerikan që jeton në Majami. Në vitin 2025 ai shiti tokë pranë rezervatit natyror ku ndohen foletë e flamingove te kompania “Albania Land Development”, e lidhur me projektin e Kushnerit. Kjo marrëveshje është vënë nën shqyrtim nga prokurorët antikorrupsion, të cilët kanë ngrirë pagesa me vlerë 128 milionë euro në pritje të përfundimit të hetimeve.

Shehu nuk iu përgjigj kërkesave për koment.


Rama argumentoi se qeveria e tij u ka dhënë prokurorëve më shumë liri për të ndjekur rastet e korrupsionit, gjë që sipas tij ka rritur perceptimin se vendi është

Albania

+ Add to myFT

‘I’m not the Godfather’, Albanian PM says

Edi Rama responds to weeks of anti-corruption protests over luxury resort linked to Trump’s son-in-law



i mbushur me korrupsion dhe krim të organizuar.

”Në fakt është e kundërta. Shqipëria po lufton si kurrë më parë dhe sot është shumë më pak e korruptuar se sa ka qenë më parë”, tha ai.

Sipas Ramës, kundërshtimi ndaj projektit është nxitur edhe nga kundërshtarët e presidentit amerikan Donald Trump, përfshirë Iranin.

”Ka shumë interesa për ta vrarë këtë projekt, sepse lidhet me Trumpin”, deklaroi ai.

”Po të mos ishte Jared Kushner,

askush nuk do t’ia dinte për flamingot, për Shqipërinë apo për asgjë tjetër. E gjithë kjo vëmendje vjen nga urrejtja ndaj Trumpit”, shton ai.

Kryeministri u shpreh i bindur se planet për zhvillimin e resortit bregdetar do të vazhdojnë pavarësisht protestave.

”E rëndësishme është që investitorët nuk janë kriminelë dhe nuk janë të përfshirë në pastrim parash”, tha Rama.

”Ata janë investitorë të mëdhenj. Kjo është një mundësi historike për Shqipërinë”, shtoi ai

Bilanci i Ferit Hoxhës: Shqipëria më e respektuar dhe më e besueshme se kurrë

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ferit Hoxha, bëri një bilanc të muajve të parë në detyrë, duke vlerësuar se Shqipëria po kalon një nga momentet më të rëndësishme të historisë së saj në politikën e jashtme.

Përmes një postimi në rrjetet sociale, Hoxha tha se ky përfundim vjen pas afro katër muajsh në detyrë, gjatë të cilëve ka zhvilluar takime me homologë nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, përfaqësues të rajonit dhe zyrtarë ndërkombëtarë, si edhe ka marrë pjesë në ministeriale, konferenca dhe forume ndërkombëtare.

Sipas tij, Shqipëria nuk ka pasur kurrë më parë një emër më të mirë në botë dhe një zë më të fortë në diplomacinë ndërkombëtare. Ai theksoi se vendi gëzon marrëdhënie të konsoliduara me partnerët dhe aleatët, ndërsa perceptimi për Shqipërinë ka ndryshuar ndjeshëm.

“Një përfundim që nuk le vend për mëdyshje. Pas afër katër muajsh në detyrë, kohë gjatë të cilës kam takuar dhe biseduar me të gjithë homologët e mi në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, në rajon dhe në mbarë hapësirën evropi-



ane; pasi kam zhvilluar qindra takime me zyrtarë, diplomatë, gazetarë, ekspertë dhe studiues që ndjekin e analizojnë zhvillimet gjeopolitike; dhe

pasi kam marrë pjesë në dhjetëra ministeriale, konferenca, forume, takime e aktivitete ndërkombëtare, një përfundim del qartë:

“

“Në çdo kryeqytet ku kam qenë gjatë kësaj kohe, kam ndjerë të njëjtën frymë dhe kam përjetuar të njëjtën gjë: Shqipëria dëgjohet me më shumë vëmendje, trajtohet me më shumë respekt dhe, mbi të gjitha, shihet si një partner serioz, i besueshëm dhe me kontribut konkret e me potencial për të ofruar më shumë, edhe për Evropën edhe për rajonin.

“Kurrë më parë në historinë e saj, Shqipëria nuk ka pasur një emër më të mirë në botë dhe një zë më të fortë në arenën ndërkombëtare. Asnjëherë më parë, Shqipëria nuk ka gëzuar marrëdhënie të tilla miqësie e bashkëpunimi, të besueshme dhe të konsoliduara me partnerët dhe aleatët e saj, si në planin dypalësh, ashtu edhe në atë shumëpalësh. Në asnjë moment të historisë sonë, Shqipëria nuk ka qenë më e respektuar, më e vlerësuar, më e dëshiruar dhe më e vizituar se sa është sot, me derën të hapur kudo dhe e mirëpritur gjithkund”, theksoi Hoxha.

Hoxha u shpreh se sot emri i Shqipërisë lidhet gjithnjë e më shumë me zhvillimin, turizmin, mikpritjen, lirinë dhe energjinë pozitive, duke e cilësuar këtë si pasqyrim të transformimit të vendit në një shtet më të hapur, konkurrues dhe të pranishëm në hartën politike, ekonomike dhe turistike të Evropës.

“Në çdo kryeqytet ku kam qenë gjatë kësaj kohe, kam ndjerë të njëjtën frymë dhe kam përjetuar të njëjtën gjë: Shqipëria dëgjohet me më shumë vëmendje, trajtohet me më shumë respekt dhe, mbi të gjitha, shihet si një partner serioz, i besueshëm dhe me kontribut konkret e me potencial për të ofruar më shumë, edhe për Evropën edhe për rajonin. “Jo më pak domethënës dhe kuptimplotë është edhe ndryshimi i perceptimit. Sot, emri Shqipëri lidhet gjithnjë e më shumë me lirinë, suksesin, zhvillimin, turizmin, mikpritjen,



Shqipëria është në prag të realizimit të ëndrrës që bashkon shqiptarët kudo ku jetojnë, në çdo cep të vendit dhe në çdo anë të globit: anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe rikthimit të plotë në përkatësinë tonë historike, politike dhe qytetëruese evropiane. Ky nuk është thjesht një moment historik. Është një mundësi që vjen një herë në breza.

Një dritare unike për të përmbushur aspiratën më të madhe kombëtare dhe për ta rikthyer Shqipërinë aty ku ka qenë gjithmonë vendi i saj i natyrshëm.



energjinë pozitive dhe një shoqëri dinamike në transformim të pandalshëm, pasqyrimi i një realiteti tërësisht të transformuar: i një Shqipërie më të hapur, më konkurruese dhe më të pranishme se kurrë më parë në hartën politike, ekonomike dhe turistike të Evropës”, tha Hoxha.

Ministri nënvizoi gjithashtu se Shqipëria ndodhet pranë realizimit të objektivit strategjik të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, të cilin e cilësoi si projektin më të madh kombëtar. Hoxha theksoi se procesi i integritetit evropian kërkon përkushtim, përgjegjësi dhe kontributin e të gjithë qytetarëve, në mënyrë që kjo mundësi historike të shndërrohet në arritjen më të madhe

të Shqipërisë demokratike dhe një trashëgimi për brezat e ardhshëm.

“Dhe, mbi të gjitha, Shqipëria është në prag të realizimit të ëndrrës që bashkon shqiptarët kudo ku jetojnë, në çdo cep të vendit dhe në çdo anë të globit: anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe rikthimit të plotë në përkatësinë tonë historike, politike dhe qytetëruese evropiane. Ky nuk është thjesht një moment historik. Është një mundësi që vjen një herë në breza. Një dritare unike për të përmbushur aspiratën më të madhe kombëtare dhe për ta rikthyer Shqipërinë aty ku ka qenë gjithmonë vendi i saj i natyrshëm.

“Por një mundësi e tillë nuk realizohet vetvetiu. Ajo kërkon edhe më shumë përkushtim, edhe më shumë përgjegjësi, edhe më shumë punë, energji dhe vendosmëri. Mbi të gjitha, kërkon kontributin e secilit prej nesh, përtej dallimeve politike, bindjeve apo vendit ku jetojmë. Sepse anëtarësimi në Bashkimin Evropian është projekti ynë kombëtar. Dhe pikërisht si i tillë, ai kërkon bashkimin e energjive tona më të mira, në mënyrë që këtë moment historik ta shndërrojmë në arritjen më të madhe të Shqipërisë demokratike dhe në një trashëgimi të qëndrueshme për brezat që do të vijnë. Vetëm një dekimë mjafton për të hedhur vështrimin pas dhe për të kuptuar se ku ishim dhe ku gjendemi sot; nga kemi ardhur dhe ku po shkojmë; çfarë trashëguam dhe çfarë duam të ndërtojmë. Të gjithë së bashku”, tha ai.

Zgjedhjet e qershorit në Kosovë, nuk prodhuan as humbës klasik dhe as fitues absolut!



Nga Prof. Dr. Fadil Maloku

SOCIOLOG

Paranteza ime e hedhur në titull, e shikuar me dioptrinë sociologjike, bëhet kureshtare për lexuesin dubioz edhe për faktin se të gjithë fokusin e zhvendos nga fituesi elektoral te projekti i nisur dhe i identifikuar politikisht si “Republika e Tretë”. Në këtë kuptim, paranteza nuk e mohon fitoren e LVV-së në zgjedhjet e 7 qershorit, por sugjeron se projekti i asaj që shquhet si “Republika e Tretë”, por që ende nuk po qarkullon publikisht si slogan, pësoi një “goditje të rëndë dhe serioze”. Kur sjellim argumentin e “goditjes serioze dhe të rëndë”, aludimi ynë i referohet prolongimit të realizimit të synimeve dhe ambicies për ta ndryshuar

ngadalë, por sigurt dhe me mjete demokratike, “arkitekturën” e Kushtetutës aktuale ahtisari-ane. Që, dorën në zemër, është koha për ta thënë edhe publikisht, se; është shndërruar në një “këmishë” tejet të ngushtë, si për proceset ashtu edhe për zhvillimet dinamike aktuale që po ndodhin në Kosovë dhe rreth Kosovës. Pra, ambicia dhe synimi për të filluar instalimin e këtij projekti, krahasuar me zgjedhjet e 28 dhjetorit, kur LVV-ja kishte marrë 51.3% të elektoratit kosovar, me zgjedhjet e 7 qershorit duket tashmë se është kthyer dy hapa prapa.

E themi kështu edhe për shkak se ideja e fillimit të instalimit dhe realizimit të kësaj narrative, e dikush do të thoshte edhe kauze e misioni i Albin Kurtit, ishte shumë më e volitshme kur LVV-

ja kishte dominim dhe epërsi absolute hegjemone në zgjedhjet e 28 dhjetorit, sesa tani kur ka një fitore johegjemonike dhe me mundësi të kufizuara.

Dhe kjo “zhveshje” e pakalkuluar sa dhe si duhet nga të qenit hegjemon absolut i skenës politike të fut në “shtigjet” e dyshimit dhe të dilemave interesante që duhet të kenë përgjigjet e duhura. E para, se projekti për “Republikën e Tretë” ose nuk është serioz dhe përdoret vetëm për “mirëmbajtje” të pushtetit. E dyta, se LVV-ja ende nuk është e gatshme që e vetme t’u futet “betejave” politike për realizimin e këtij synimi me ambicie kombëtare. E treta, se ky subjekt hegjemon është në kërkim të një partneri të fuqishëm e kredibil për ta implementuar këtë mision, që për të është edhe interes kombëtar. Dhe e katërta, se Albin

Kurti, si ideator, është duke pritur një moment më të volitshëm që, me gjasa, do të krijohet pas përfundimit të “kaosit të kontrolluar” global që është duke ndodhur në gjithë botën.

Në gjykimin tim, meqë nuk kemi përgjigjen e saktë në këto përpjekje, ka gjasa që këto opsione apo edhe dyshime të (pa)bazuara të jenë qëllimisht të lëna të hapura edhe për një fakt. E ai fakt ka të bëjë me taktikën apo strategjinë e njohur kur një fitues hegjemon zakonisht bën: “Një hap elektoral para, e dy hapa politikë prapa.” Që, në situatën tonë aktuale politike, do të mund të interpretohej edhe kështu: “Një mandat më shumë për liderin, por një hap prapa për Republikën e Tretë”, ose Një hap para në marrjen e legjitimitetit të dalur nga zgjedhjet dhe dy hapa prapa në procesin e fillimit të ndryshimit kushtetues. Më 7 qershor, Kosova i dha Kurtit edhe një mandat për qeverisje, por jo edhe mandat për “Republikën e Tretë”.

Tani, nëse nisemi nga akti dhe fakti se zgjedhjet e vitit 2026 prodhuan një realitet pak a shumë identik, që nënkupton një “legjitimitet” të ri weberian, ku nga lideri kërkohet që kjo fitore (qoftë ajo edhe “fitore e Pirros”!) të mund të shndërrohet në një konsensus gjithëkombëtar, kuptojmë se jemi në rrugë të mbarë edhe për sfidat tjera dinamike që e presin Kosovën edhe në planin e jashtëm...

Duket paksa utopike kjo strategji hipotetike, mirëpo, me fjalë të tjera, votuesit kosovarë edhe kësaj here shprehën vullnetin e tyre për t'i besuar Kurtit si lider, por jo aq sa ai ka pritur për t'ia deleguar rindërtimin dhe fillimin e ndryshimit të rendit aktual

institucional të Kosovës.

A i hasi “gozhda në sharrë” “Republikës së Tretë”?

Dhe nëse tani analizojmë ad hoc projektin për “Republikën e Tretë”, kuptojmë se ky projekt është paraparë, në gjykimin tim, të realizohet në tri etapa: ajo e protestimit, që identifikohet me kohën kur LVV-ja ishte në margjinat opozitare; ajo e qeverisjes, që ka të bëjë me periudhën gjashtëvjeçare të pushtetmbajtjes; dhe faza e tretë, që ka të bëjë me fillimin e implementimit gradual të projektit në fjalë, që duket se i ka hasur “gozhda në sharrë” me zgjedhjet e qershorit. Thënë më ndryshe, i tërë ngërçi institucional apo mosmarrëveshjet politike që u “prodhuan” artificialisht në këta tetëmbëdhjetë muaj janë bërë ajo “gozhda në sharrë” për funksionalizimin e institucioneve të Kosovës.

Pra, zgjedhjet e qershorit prodhuan një situatë simptomatike, ku qytetarët e Kosovës ia dhanë votën për të vazhduar qeverisjen e Kurtit 4, por nuk ia dhanë edhe mandatin për hegjemoninë e projektit të “Republikës së Tretë”. Megjithatë, siç thuhet, fitues i vërtetë nuk është gjithherë subjekti që fiton zgjedhjet dhe bëhet hegjemon i krijimit të institucioneve paszgjedhore, por subjekti apo partia që arrin ta fitojë besimin dhe “mendjen kolektive” të qytetarisë së një vendi.

